



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim
Agencija Kosova za Akreditaciju
Kosovo Accreditation Agency



Data: 18/07/2022 Ref.: 941/22

Në mbështetje të nenit 8 dhe 12 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura Republikës së Kosovës (GZ. Nr.07/01 mars 2019), Ligjit Nr.05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative (GZ. Nr.20/12 Qershor 2016), neni 7, dhe neni 15 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ. Nr.14/9 Shtator 2011), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018) dhe Manualit për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë, Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC), në mbledhjen e 101-të, të mbajtur më 30.06.2022, mori:

V E N D I M

- I. **Riakreditohen** programet e studimit në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Ndërtimtarisë, për periudhën pesë (5) vjeçare, 1 tetor 2022 – 30 shtator 2027:
 1. *Inxhinieria e Ambientit, BSc*, 180 ECTS, maksimumi 40 studentë për vit akademik,
 2. *Gjeodezi, MSc*, 120 ECTS, maksimumi 20 studentë për vit akademik,
- II. Numri i përcaktuar i studentëve aplikohet për të gjitha vitet e studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Fakulteti i Ndërtimtarisë në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” që deri më datë 15.11.2022 të dorëzojë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Fakulteti i Ndërtimtarisë në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina” të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA brenda 90 ditëve. Lista e përditësuar e bartësve aprovohet nga KSHC.
- V. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
- VI. Institucioni i Arsimit të Lartë si në pikën I, mbanë përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkalim të këtij vendimi.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

ARSYETIM

Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” Fakulteti i Ndërtimtarisë në Prishtinë në afatin ligjor ka parashtruar kërkesë pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) për ri akreditim të programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Inxhinieria e Ambientit, BSc, 180 ECTS,</i> Riakreditim	Figene Ahmedi Cenë Krasniqi Zijadin Guri
2	<i>Gjeodezi, MSc, 120 ECTS</i> Riakreditim	Përparim Ameti Ymer Kuka

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizita me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Universitetin e Prishtinës “Hasan Prishtina”, Fakulteti i Ndërtimtarisë në Prishtinë me këtë përbërje: Gabor Dombay, Alvar Soesoo dhe Marko Komso. Vizita është organizuar me datë: 17.05.2022.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, Ekipi i Vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit dhe për secilin program, për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit *Inxhinieria e Ambientit, BSc, 180 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht gjashtë (6) dhe substancialisht një (1) standarde.
- Për programin e studimit *Gjeodezi, MSc, 120 ECTS*, nga shtatë fusha të standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: plotësisht shtat (7) standarde.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë (KSHC) në mbledhjen e 101 të mbajtur më 30.06.2022 ka shqyrtuar aplikacionin e Fakultetit të Ndërtimtarisë dhe duke u bazuar në të gjeturat e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqitet ankesë sipas nenit 125 dhe 126, Ligjit Nr. 05/L-31 për Procedurën e Përgjithshëm Administrative. Ankesa kundër këtij akti administrativ i dorëzohet organit i cili e ka nxjerr këtë vendim bazuar në nenit 128 të LPPA, në afatin prej 30 ditë nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ sipas nenit 127 të LPPA. Inicimi i konfliktit administrativ apo çfarëdo procedure tjetër administrative nuk e pengon ekzekutimin e këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Fakultetit të Ndërtimtarisë të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së.


Prof. Ass. Dr. Hasnija Ilaz
Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë

